

VENDIM
Nr. 630, datë 7.9.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS UNAZA “1 MAJI”, HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës, unaza “1 Maji”, Himarë”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Himarë.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë sipërfaqe “tokë truall” dhe “objekt”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit 2 033 529 (dy milionë e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 033 529 (dy milionë e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e nëntë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë në datën e botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Himarë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transak-sionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NË ZBATIM TË PROJEKTTIT
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS UNAZA “1 MAJI”, HIMARË”

Nr.	Pronari		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e truallit	Çmimi	Vlera truallit lekë	Vlera e objektit, lekë	Vlera e pasurisë, lekë	Shënime
	Emër	Mbiemër					lekë/m ² Truall				
1	Gogo	Naci	1952	3334	Pikë karburanti	225	4350	978,750	1,054,778.6	2,033,528.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
								VLERA TOTALE		2,033,528.60	

